


Të njohim Europën!



Bashkimi Europian



Këtë broshurë në gjuhën shqipe dhe angleze si dhe shpjegime të tjera më të hollësishme mund t'i gjeni në
ec.europa.eu/com/publications
<http://smei3.mie.gov.al/en/pages/Home>
<http://integrimi.gov.al/>

Komisioni Europian
Drejtoria e Përgjithshme për Komunikimin
Publikimet
1049 Bruksel
BELGJIKË

Botimi në gjuhën shqipe u përgatit në kuadër të projektit të asistencës teknike SMEI 3 «Mbështetje për Procesin e Integritimit Europian – faza III», financuar nga Bashkimi Europian (IPA 2010).

Ilustrimet: Birte Cordes dhe Ronald Köhler

Luksemburg
Zyra e Publikimeve të Bashkimit Europian, 2013

ISBN 978-92-79-32925-8
doi:10.2775/3158

44 fq. [21.0 x 29.7 cm] shtojca [10.5 x 14.8 cm]
©Bashkimi Europian, 2012
Riprodhimi është i autorizuar

Printuar në Shqipëri





Të njohim Europën!

Përshëndetje! Mirësevini në Europë!

Ne vijmë nga vende të ndryshme dhe flasim gjuhë të ndryshme, por ky kontinent është shtëpia jonë e përbashkët.

Ejani me ne ta zbulojmë Europën së bashku! Ky do të jetë një rrugëtim plot aventura në kohë dhe në hapësirë, ku do të gjeni shumë gjëra interesante.

Gjatë këtij rrugëtimi, kontrolloni veten për të parë se sa keni mësuar. Për ta bërë këtë, shkoni në faqen tonë të internetit europa.eu/kids-corner, ku do të gjeni lojën "Të zbulojmë Europën" si dhe shumë gjëza dhe lojëra të tjera mbi Europën.

Në shkollë bëni zbulime të tjera! Kërkoni nga mësuesi juaj t'ju flasë më shumë për secilën nga temat në këtë libër. Pastaj, bëni hulumtime më të thella në bibliotekën e shkollës ose në internet. Ju madje mund të shkruani edhe një libërth tuajin lidhur me atë që keni zbuluar.

Gati? Le t'ia fillojmë!

Çfarë përmban ky libër?

	Faqe
Një kontinent për t'u zbuluar	3
Mënyrat e transportimit	6
Gjuhët në Europë	8
Klima dhe natyra	10
Bujqësia dhe blegtoria	13
Deti	15
Rrugëtim në kohë	19
Dyzet personalitetet më të famshme - shtojca	
Prëfimi për Bashkimin Europian	30
Çfarë bën BE-ja	34
BE-ja dhe fqinjët e saj - harta	37
Vendet e Bashkimit Europian	38
Ta gjurmojmë Europën! Kuiz	39
Si merren vendimet në BE	40
E nesërmja ... dhe pas saj	42
Referenca të dobishme për ju dhe mësuesin tuaj	44

Një kontinent për t'u zbuluar

Europa është një nga shtatë kontinentet e botës. Kontinentet e tjera janë Afrika, Amerika Veriore, Amerika Jugore, Antarktiku, Azia dhe Australia/Oqeania.

Europa shtrihet nga Arktiku në veri deri në detin Mesdhe në jug, si dhe nga Oqeani Atlantik në perëndim deri te Malet Urale (Rusi) në lindje. Ka shumë lumenj, liqene dhe vargmale. Harta në faqen 4 tregon emërtimet e disa prej lumenjve, liqenjve dhe vargmaleve më të mëdha.

Mali më i lartë në Europë është Mali Elbrus, në malet e Kaukazit, në kufirin midis Rusisë dhe Gjeorgjisë. Maja e tij arrin 5.642 metra mbi nivelin e detit.

Mali më i lartë në Europën Perëndimore është Mont Blanc, në Alpet në kufirin midis Francës dhe Italisë. Maja e tij arrin në 4.800 metra mbi nivelin e detit.

Po ashtu, në Alpe gjendet edhe liqeni i Gjenevës, liqeni më i madh në Europën Perëndimore. Ky liqen shtrihet midis Francës dhe Zvicrës, ka një thellësi maksimale prej 310 metrash, dhe përmban rreth 89 trilionë litra ujë.

Liqeni më i madh në Europën Qendrore është Balatoni në Hungari. Ky liqen është 77 kilometra i gjatë dhe mbulon një sipërfaqe prej 600 kilometrash katrore (km²). Europa veriore ka liqene edhe më të mëdhenj, duke përfshirë liqenin Saima (Saimaa) në Finlandë (1.147 km²) dhe Venern (Vänern) në Suedi (më shumë se 5.500 km²). Liqeni më i madh në Europë është liqeni Ladoga. Ky liqen gjendet në Rusinë veri-perëndimore, dhe është liqeni i 14-të për nga madhësia në botë. Sipërfaqja e tij shtrihet në 17.700 km².



© Michael/Pixelio

Mali Elbrus, mali më i lartë në Europë



© Pixelio

Liqeni Gjeneva në Alpe.



© Kratos May/Flickr

Liqeni Saimaa, në Finlandë.

Kontinenti i Europës



*Delta
Danubiane,
Rumani.*



© Pixelio

Një nga lumenjtë më të gjatë të Europës është Danubi. Ky lumë buron në rajonin e Pyllit të Zi të Gjermanisë, rrjedh në drejtim të lindjes përmes Austrisë, Sllovakisë, Hungarisë, Kroacisë, Serbisë, Bullgarisë, Moldavisë dhe Ukrainës deri në Rumani, ku formon një deltë në brigjet e Detit të Zi. Gjatësia e përgjithshme e këtij lumi është rreth 2.850 km.

*Lugina e Luares
është e famshme
për këshjtjellat
e saj të bukura.*



© Flickr

Lumenjtë e tjerë të mëdhenj janë Rini (rreth 1.320 km i gjatë), Elba (rreth 1.170 km), si dhe Luara dhe Vistula (së bashku më shumë se 1.000 km). A mund t'i gjeni në hartë?


*Një anije
ngarkuese
udhëton
në Rajna.*



© Fridmar Damn/Corbis

Lumenjtë e mëdhenj janë shumë të dobishëm për transportimin e mallrave të ndryshme. Mallra të ndryshme ngarkohen në lundra, që i transportojnë ato nëpër lumenj prej porteve detare dhe qyteteve të Europës në brendësi të territorit.

Duke udhëtuar




'Raketa' e Stensonit.

A e keni ditur se hekurudhat janë zbuluar në Europë? Ato janë zbuluar në Angli nga Xhorxh Stivenson (George Stephenson), i cili zbuloi trenin e parë të udhëtarëve në vitin 1825. Lokomotiva e tij më e famshme është quajtur 'Raketë', dhe ka arritur shpejtësinë prej më shumë se 40 kilometra në orë (km/h) — që ka qenë një shpejtësi shumë e madhe në ato kohë.

Sot, trenat elektrikë të shpejtësisë së lartë dallojnë shumë nga lokomotivat e para me avull. Trenat e sotëm janë shumë të rehatshëm, dhe lëvizin me shpejtësi deri në 330 km në orë në binarë të posaçëm. Hekurudha janë duke u ndërtuar gjithnjë e më shumë në mënyrë që njerëzit të kenë mundësinë të udhëtojnë shpejt prej një qyteti në një qytet tjetër të madh të Europës.

Rrugët dhe hekurudhat nganjëherë duhet të kalojnë nëpër vargmale, lumenj të gjerë apo edhe nën dete. Rrjedhimisht, inxhinierët kanë ndërtuar ura dhe tunele shumë të gjata. Tuneli më i gjatë rrugor në Europë është tuneli Laerdal në Norvegji, midis qyteteve të Bergenit dhe Oslos. Ky tunel është më shumë se 24 km i gjatë dhe është hapur në vitin 2000.

Tuneli më i gjatë hekurudhor në Europë është tuneli Çanell (Channel). Nëpër këtë tunel kalojnë nën det trenat e shpejtësisë së lartë Eurostar, të cilët përshkojnë rrugën midis qytetit Kale (Calais), në Francë dhe Folkston (Folkestone), në Angli. Ky tunel është më shumë se 50 km i gjatë.



Trenat Eurostar në stacionin St Pancras (Londër).



© Colin Garratt/Corbis

Ura më e lartë në botë (245 metra e lartë) është Viadukti Millu (Millau Viaduct) në Francë, e cila është hapur në vitin 2004.

Dy nga urat më të gjata në Europë janë rruga Oresund dhe ura hekurudhore (16 km e gjatë) midis Danimarkës dhe Suedisë, si dhe ura në rrugën Vasko da Gama (më shumë se 17 km e gjatë) mbi lumin Taugus në Portugali. Ura Vasko da Gama ka marrë emrin e një zbuluesi të famshëm, për të cilin mund të lexoni në kapitullin 'Udhëtim në kohë'.



Ura më e lartë në botë – Millau Viaduct (Francë).



Aeroplani më i shpejtë për pasagjerë i ndërtuar ndonjëherë, Konkordi

Aeroplani më i madh në botë për pasagjerë – Airbus A380.

Njerëzit udhëtojnë nëpër Europë edhe me aeroplan sepse udhëtimi me aeroplan është më i shpejtë. Disa nga aeroplanët më të mirë në botë prodhohen në Europë, për shembull, 'Airbusi'. Vendet e ndryshme të Europës prodhojnë pjesë të ndryshme të Airbusit, dhe pastaj ekipi i inxhinierëve monton gjithë aeroplanin.

Aeroplani më i shpejtë i udhëtarëve i prodhuar ndonjëherë, Konkordi, është projektuar nga një ekip i inxhinierëve francezë dhe britanikë. Konkordi ka fluturuar me shpejtësi prej 2160 km/h, dy herë më shpejt se shpejtësia e zërit dhe e ka kaluar Oqeanin Atlantik në më pak se tre orë! (për shumicën e aeroplanëve nevojiten tetë orë.) Konkordi bëri fluturimin e tij të fundit në vitin 2003.

Më të shpejta se çdo aeroplan janë raketat kozmike, siç është Ariana, një projekt i përbashkët i disa vendeve europiane. Njerëzit nuk udhëtojnë në raketën Ariana; ajo përdoret për dërgimin e satelitëve që nevojiten për rrjetet televizive dhe të telefonisë celulare, për kërkime shkencore dhe të tjera. Shumica e satelitëve të botës tani dërgohen përmes këtyre raketave europiane.

Suksesi i Konkordit, Airbusit dhe Arianës tregon se ç'mund të arrihet kur vendet europiane bashkëpunojnë.



Gjuhët në Europë

Popujt e Europës flasin shumë gjuhë të ndryshme. Shumica e këtyre gjuhëve u përkasin tri grupeve apo 'familjeve' të mëdha të gjuhëve: gjermanike, sllave dhe latine.

Gjuhët në secilin grup kanë ngjashmëri me familjen e gjuhës së tyre mbasi kanë prejardhje nga paraardhës të përbashkët. Për shembull gjuhët romake rrjedhin nga gjuha latine – gjuhë kjo e folur nga romakët.

Ja se si thuhet 'mirëmngjes' apo 'tungjatjeta' në disa prej këtyre gjuhëve

Gjermanike

Daneze	God morgen
Holandeze	Goedemorgen
Angleze	Good morning
Gjermane	Guten Morgen
Suedeze	God morgon


Romake

Franceze	Bonjour
Italiane	Buongiorno
Portugeze	Bom dia
Rumune	Bună dimineața
Spanjolle	Buenos días

Sllave

Bullgare	Dobró útro
Çeke	Dobré ráno
Polake	Dzień dobry
Sllovake	Dobré ráno
Sllovene	Dobro jutro





Flamujt e të gjitha shteteve të BE-së mund t'i gjeni në faqen 38.

Nuk është vështirë të vërehen ngjashmëritë midis gjuhëve nga e njëjta familje. Gjithashtu, ekzistojnë edhe gjuhë të tjera europiane që janë më pak të ndërlidhura apo nuk janë fare të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

Ja se si thuhet 'mirëmëngjes' apo 'tungjatjeta' në disa prej këtyre gjuhëve.

Baske	Egun on
Bretone	Demat
Katalunase	Bon dia
Estoneze	Tere hommikust
Finlandeze	Hyvää huomenta
Galike (Skoceze)	Madainn mhath
Greke	Kalimera
Hungareze	Jó reggelt
Irlandeze	Dia dhuit
Letoneze	Labrīt
Lituaneze	Labas rytas
Malteze	L-Għodwa t-Tajba
Uellsiane	Bore da


Në gjuhën e popullit rom, që jeton në shumë pjesë të Europës, 'mirëmëngjes' thuhet *Lasho dyes*.

Të mësuarit e gjuhëve mund të jetë një kënaqësi shumë e madhe dhe një gjë e tillë është e rëndësishme në një kontinent si ky i yni. Shumë nga ne kënaqen duke shkuar me pushime në vendet europiane dhe duke u njohur me njerëzit e atjeshëm. Kjo është një mundësi shumë e mirë për t'i praktikuar fjalët dhe fjalitë që dimë në gjuhë të ndryshme.



Dhelpra e Arktikut ...

Klima dhe natyra



... dhe bufi i dëborës janë maskuar mirë.

Pjesa më e madhe e Europës ka një klimë të butë, as shumë të nxehtë dhe as shumë të ftohtë. Vendet më të ftohta janë në veriun e largët dhe në malet e larta, ndërsa vendet më të ngrohta janë në jugun e skajshëm dhe në juglindje.

Moti është më i ngrohtë dhe më i thatë në verë (prej qershorit deri në shtator) dhe më i ftohtë në dimër (prej dhjetorit deri në mars).

Vera më e nxehtë në Europë ishte në vitet 2003 dhe 2006. A është kjo një shenjë se klima po ndryshon? Ndryshimi klimatik është problem botëror që mund të zgjidhet vetëm nëse të gjitha vendet bashkëpunojnë.

Përballimi i dimrit




© Klaus Hackenberg/Corbis

Shtazët e egra në rajonet e ftohta zakonisht kanë gëzof apo pupla të trasha për të mbajtur ngrohtësinë. Gëzofi i tyre mund të jetë edhe i bardhë për tu kamufluar në borë. Disa nga këto shtazë e kalojnë dimrin në gjumë për të ruajtur energji. Kjo quhet rënie në gjumë ose në letargji.



Arinjtë ngjyrë kafe europianë jetojnë në male ku e kalojnë dimrin në gjumë.





Shumë lloje zogjsh ushqehen me insekte, gjallesa të vogla ujore apo me ushqime të tjera që nuk mund të gjenden lehtë gjatë muajve të ftohtë të dimrit. Kështu që këta zogj gjatë vjeshtës fluturojnë në jug dhe nuk kthehen deri në pranverë. Disa madje fluturojnë me mijëra kilometra përgjatë Detit Mesdhe dhe shkretëtirës së Saharasë për të kaluar dimrin në Afrikë. Ky fluturim stinor quhet shtegtim.

Kënaqësia e pranverës dhe verës

Kur vjen pranvera në Europë (prej marsit deri në maj), moti bëhet më i nxehtë. Bora dhe akulli shkrihen. Peshqit e vegjël dhe larvat e insekteve jetojnë në përrenj dhe pellgje. Zogjtë shtegtarë kthehen për t'i ndërtuar foletë dhe për të rritur të vegjlit e tyre. Lulet çelin, ndërsa bletët bartin polenin prej njëres bime në tjetrën.

Pemët vishen me petkun e ri të gjelbër, i cili tërheq dritën e diellit dhe shfrytëzon energjinë e tij për ta rritur pemën. Në vendet malore, blegtorët e dërgojnë bagëtinë në livadhe, ku tani ka bar të njomë me bollëk.

Edhe flamingot vijnë në Europë në pranverë.




Vera është e këndshme në livadhet malore.

Kafshët gjakftohta, siç janë zvarranikët, gjithashtu kanë nevojë për diell. Gjatë verës, posaçërisht në Europën jugore, shpesh mund të shihni hardhuca, duke u ngrohur në diell, si dhe mund të dëgjoni cicërimin e karkalecave dhe gjinkallave.



Zvarranikët pëlqejnë motin e ngrohtë.



Grerëzat i duan frutat gjithashtu!

Vjeshta: kohë e ndryshimit

Në verën e vonshme dhe në vjeshtë, ditët sa vijnë e shkurtohen, ndërsa netët bëhen më të ftohta. Shumë fruta të shijshme piqen në këtë kohë të vitit dhe bujqit merren me vjeljen e tyre. Në vjeshtë, piqen edhe aroret, ndërsa ketrat i mbledhin dhe i ruajnë për dimër.



Ketrat grumbullojnë lajthitë si ushqim gjatë dimrit.

Në vjeshtë shumë drunj zhvishen nga petku i tyre i gjelbër sepse nuk ka diell të mjaftueshëm për t'i mbajtur në jetë gjethet. Ata gradualisht ndryshojnë ngjyrën prej të gjelbrës në nuanca të të verdhës, të kuqes, të ngjyrës së arit dhe të gështenjës. Gjethet e rëna kalben, duke ushqyer kështu dheun për brezat e ardhshëm të bimësisë.

Ky cikël vjetor i stinëve dhe ndryshimi që vjen me të, e bëjnë natyrën e Europës, të bukur dhe shumë e larmishme.

Vjeshta i vesh pemët me ngjyra.

Bujqësia dhe blegtoria

Në malet e larta dhe në veriun e skajshëm të Europës, zhvillimi i bujqësisë dhe i blegtorisë është i pamundur pasi atje mbretëron i ftohtë i madh dhe kulturat e ndryshme bujqësore nuk mund të kultivohen. Mirëpo, drurët gjethembajtës, siç janë pishat dhe llojet e tjera të bredhave mund t'u mbijetojnë dimrave të ftohtë. Kjo është arsyeja pse vendet më të ftohta në Europë janë të mbuluara nga pyjet halore. Njerëzit kanë shfrytëzuar drurët e këtyre pyjeve për të bërë shumë gjëra, duke filluar nga shtëpitë dhe mobiljet e deri te letra dhe ambalazhet e ndryshme.



Më tej në jug, pjesa më e madhe e tokës është e përshtatshme për blegtori e bujqësi. Në këto toka mund të kultivohen kultura të ndryshme bujqësore, duke përfshirë grurin, misrin, panxharsheqerin, patatet dhe të gjitha llojet e frutave e perimeve.



Atje ku ka shumë diell dhe shumë pak akull (afër Mesdheut, për shembull), bujqit mund të kultivojnë fruta, siç janë portokallet, limonat, rrushi dhe ullinjtë. Ullinjtë përmbajnë vaj që mund të shtrydhet dhe të përdoret për përgatitjen e ushqimit. Nga shtrydhja e rrushit përfitohet lëngu, që mund të shndërrohet në verë. Europa është e famshme për verërat e veta shumë të mira, të cilat shiten në mbarë botën.

Bujqit e Mesdheut gjithashtu kultivojnë shumë fruta e perime të tjera. Domatet, për shembull, piqen mirë nën diellin e viseve jugore, por perimet kanë nevojë për shumë ujë, kështu që bujqit në vendet e nxehta dhe të thata shpesh duhet t'i ujin kulturat e tyre. Kjo nënkupton ujitjen e tyre nga ujërat e lumenjve apo nga ujërat nëntokësorë.

Ky rrush do të bëhet verë e kuqe



Kulturat në vendet e thata kanë nevojë për ujitje.



Delet po kullotin në kullota.

Pulat japin vezë të cilat përmbajnë shumë proteina dhe na ndihmojnë të jemi të shëndetshëm.



Bari rritet shpejt aty ku ka shi të mjaftueshëm, edhe nëse dheu është i cekët dhe jo shumë pjellor. Shumë fermerë të Europës mbajnë kafshë shtëpiake barngrënëse, siç janë lopët, delet apo dhitë. Ato japin qumësht, mish dhe prodhime të tjera të dobishme, siç janë leshi e lëkura.

Shumë fermerë po ashtu mbajnë derra dhe pula. Këto kafshë mund të mbahen pothuajse gjithkund, sepse ato mund të mbahen në vende të mbyllura dhe mund t'u jepet ushqim i posaçëm. Nga pulat nuk përfitohet vetëm mishi, por edhe vezët, ku disa ferma prodhojnë me mijëra vezë çdo ditë.

Fermat në Europë janë të madhësive të ndryshme, duke filluar nga ato më të voglat e deri te më të mëdhatë. Disa ferma kanë sipërfaqe të mëdha, të cilat e lehtësojnë korrje-shirjen e drithërave përmes makinerive të mëdha bujqësore. Fermat e tjera në vende kodrinore mund të kenë sipërfaqe të vogla. Muret apo gardhet midis arave ndalojnë erozionin e dheut nga erërat dhe shiu, dhe po ashtu mund të jenë të dobishme për shtazët e egra.

Shumë banorë të qyteteve kanë dëshirë të kalojnë fundjavën dhe pushimet në fshatrat e Europës, duke u kënaqur me pamjet, paqen, qetësinë dhe ajrin e pastër. Ne të gjithë duhet të bëjmë çdo gjë që është e mundur që ta ruajmë natyrën dhe ta mbajmë të bukur.



Të jetosh në fshat është kënaqësi për këdo.

Derrat mund të mbahen brenda në shtëpi.

Një mozaik i fushave në Europë.

© Sylvain Sausther/Corbis

Deti



Zogu i detit bën folenë në shkëmbinjë, dhe zhytet në ujë për të kapur peshk.

Europa ka mijëra e mijëra kilometra bregdet, të cilin natyra e ka formësuar në mënyra të ndryshme. Ky bregdet është i pasur me brigje shkëmbore dhe plazhe me rërë apo me guralecë të ngjyrave të ndryshme, të formuar nga deti që përplasat në brigjet shkëmbore shekull pas shekulli.

Në Norvegji, akullnajat kanë skalitur bregdetin në lugina të rrëpira, të quajtura fjorde. Në disa vende të tjera, deti dhe era e grumbullojnë rërën në kodra rëre apo duna. Duna (Kodra e rërës) më e lartë në Europë (117 metra) është Duna du Pyla, afër Arkashonit (Arcachon) në Francë.

Shumë lloje të peshkut dhe të gjallesave të tjera jetojnë në detet e Europës. Ato janë ushqim i zogjve dhe i gjitarëve të detit, siç janë fokat. Në derdhjet e lumenjve në det, vinë edhe tufa lejkësh për t'u ushqyer me gjallesa që jetojnë në baltë.

Një nga kafshët më të rralla të Europës, foka murg, e cila jeton në Mesdhe.



Tufat e lejkëve në grykëderdhjet e deteve

Deti ka formësuar këta shkëmbinj gëlqerorë.



Një akullnajë ka gdhendur këtë fjord.



Kodra e rërës Duna du Pyla, më e larta në Europë.



Njerëzit dhe deti

Deti është i rëndësishëm edhe për njerëzit. Mesdheu ka qenë aq i rëndësishëm për romakët sa që e kanë quajtur Mare Nostrum, 'deti ynë'. Gjatë shekujve të kaluar, europianët kanë lundruar në oqeanet botërore, kanë zbuluar kontinentet e tjera, i kanë hulumtuar ato dhe kanë ndërtuar shtëpitë e veta atje. Në kapitullin 'Një udhëtim në kohë' mund të gjeni më shumë për këto udhëtime të famshme të zbulimit.

Anijet transportuese nga mbarë bota sjellin lloje të ndryshme mallrash (shpesh të vendosura në kontejnerë) në portet e Europës. Këtu, mallrat shkarkohen dhe ngarkohen nëpër trena, kamionë dhe maune. Pastaj, anijet ngarkohen me mallra që janë prodhuar në Europë dhe që do të shiten në kontinente të tjera.

Anijet kontejnerë sjellin mallra në Europë dhe gjithashtu dërgojnë nga Europa.


Disa nga anijet më të mira të botës janë ndërtuar në Europë. Aty përfshihet anija Mbretëresha Meri 2 (Queen Mary 2), një nga anijet më të mëdha të udhëtarëve në botë. Ajo bëri udhëtimin e saj të parë trans-oqeanik në janar të vitit 2004.

Një nga anijet më të mëdha të udhëtarëve në botë, Queen Mary 2.




Zhytje në Mesdhe.

Vendet turistike bregdetare të Europës janë vende të mrekullueshme për të kaluar pushimet. Atje mund të përjetoni të gjitha llojet e sporteve të ujit, duke nisur që nga sërfi dhe lundrimi dhe deri te skitë dhe zhytja në ujë.



Ju gjithashtu mund të shkoni për të pushuar, duke bërë banjo dielli apo duke u larë në det.



Nuk është gjithmonë e nevojshme barka për të shkuar për peshkim.

Europeanët hanë shumë lloje peshqish. Tuna është një nga më të mëdhenjtë!

Peshkimi

Peshkimi ka qenë gjithmonë i rëndësishëm për njerëzit në Europë. Qytete të tëra janë rritur përreth porteve të peshkimit, ku mijëra njerëz, kanë zënë apo kanë shitur peshk, për të siguruar jetesën për vete dhe familjet e tyre.

Anijet moderne të peshkimit si anijet fabrika zenë sasi të mëdha peshku. Për t'u siguruar që ne det është lënë një sasi e mjaftueshme peshku, vendet europiane kanë vënë rregulla mbi sasinë e peshkut që mund të zihet dhe mbi përdorimin e rrjetave, të cilat lejojnë daljen e peshqëve të vegjël.


Një mënyrë tjetër për të pasur peshk të mjaftueshëm, është kultivimi i tij. Në brigjet e Europës veriore salmoni kultivohet në kafazë të mëdhej në det. Në të njëjtën mënyrë mund të kultivohen edhe butakët, si midhjet, molusqet, etj.



Një barkë peshkimi hyn në dok në Skye, Skoci.




Kultivimi i salmonit.



Mbrojtja e bregdetit të Europës

Detrat dhe brigjet europiane janë të rëndësishme si për peshqit dhe gjallesat detare, ashtu edhe për njerëzit. Kështu që ne duhet të kujdesemi për to. Duhet t'i mbrojmë nga ndotja prej fabrikave dhe qyteteve. Nganjëherë çisternat e naftës pësojnë aksidente, duke derdhur sasi të mëdha naftë në det. Kjo mund të ketë pasoja të rrezikshme për plazhet, si dhe të shkaktojë ngodhjen e mijëra zogjve detare.


Vendet europiane janë duke punuar së bashku për të parandaluar që këto gjëra të ndodhin dhe për t'u siguruar që bregdeti i ynë të mbetet i bukur edhe për brezat e ardhshëm.



Një udhëtim në kohë

Gjatë mijëra vjetëve, Europa ka ndryshuar pa masë.

Ky është një rrëfim mbresëlënës, por i gjatë, kështu që këtu do të përmendim vetëm disa gjëra kryesore.



Një mjet guri nga Epoka e Gurit.



Koha e Gurit

Njerëzit e parë në Europë kanë qenë gjuetarë dhe grumbullues. Në muret e disa shpellave, ata kanë bërë vizatime të mrekullueshme të momenteve të gjuetisë. Me kalimin e kohës, ata mësuhan se si të rrisin kafshët, të kultivojnë drithërat dhe të jetojnë në fshatra.

Ata kanë përdorur gurin për të bërë armët dhe mjetet e tyre të punës, si për shembull duke e mprehur gurin e strallit.




Pikturat parahistorike në shpella në Lascaux, Francë.




Koha e Bronzit dhe Hekurit – si u mësuha përdorimi i metalit

Mijëra vjet para erës së re (para lindjes së Krishtit), njerëzit kanë zbuluar mënyrën e përfitimit të metaleve të ndryshme përmes nxehjes së gurëve në zjarr. Bronzi, i cili është një përzierje e bakrit dhe kallajit, ka qenë mjaft i vështirë për prodhimin e mjeteve të punës dhe të armëve. Ari dhe argjendi kanë qenë të butë, por shumë të bukur, kështu që prej tyre mund të bëheshin stoli.

Më vonë u zbulua një metal edhe më i fortë, hekuri. Por metali më i mirë ka qenë çeliku, i cili ka qenë i fortë dhe nuk thyhej lehtë, kështu që nga ky metal janë prodhuar shpata të cilësisë së lartë. Mirëpo, prodhimi i çelikut ka qenë mjaft i vështirë, kështu që shpatat e mira kanë qenë të rralla dhe të çmueshme.




Një sëpatë me kokë bronzi.



Greqia antike

përafërsisht prej vitit 2000 deri në vitin 200 para erës së re (p.e.r) – para lindjes së Krishtit


Para 4000 vitesh, në Greqi njerëzit filluan të ndërtojnë qytete. Fillimisht, ato janë sunduar nga mbretërit, ndërsa më vonë rreth vitit 500 p.e.r, qyteti i Athinës futi sistemin demokratik, që do të thotë qeverisje nga populli, pra në vend të mbretit, burrat e Athinës filluan të merrnin vendime përmes votimit. Demokracia është një zbulim i rëndësishëm europian, i cili është përhapur në tërë botën.




Kjo vazo Greke e pikturuar me figura të kuqe daton nga viti 530 p.e.s

Disa nga gjërat e tjera që na kanë dhënë grekët e vjetër janë:

- > Rrëfimet e mrekullueshme për zotat, luftërat dhe aventurat;
- > Tempujt elegantë, statujat e mermerit dhe poçaria e mrekullueshme;
- > Lojërat olimpike;
- > Teatrot e mirëprojektuara dhe shkrimtarët e mëdhenj, dramat e të cilëve shfaqen edhe sot e kësaj dite;
- > Mësuesit, siç kanë qenë Sokrati dhe Platoni, të cilët i mësuan njerëzit se si të mendojnë në mënyrë logjike;
- > Matematicienët, siç kanë qenë Euklidi dhe Pitagora, të cilët zbuluan modele dhe rregulla matematikore;
- > Shkencëtarët, siç kanë qenë Aristoteli (i cili ka studiuar botën bimore dhe shtazore) dhe Eratosteni (i cili provoi se toka është një sferë dhe përcaktoi madhësinë e saj).



Platoni, një nga mendimtarët më të mëdhenj të botës.



Perandoria romake

Përafërsisht prej vitit 500 p.e.r deri në vitin 500 të erës së re – pas lindjes së Krishtit

Roma fillimisht ishte vetëm një fshat në Itali. Por romakët ishin shumë mirë të organizuar, ushtria e tyre ishte shumë e mirë në luftë dhe gradualisht ata pushtuan të gjitha tokat rreth detit Mesdhe. Me kalimin e kohës, perandoria romake shtrihej duke filluar nga Anglia veriore e deri në shkretëtirën e Saharasë dhe nga oqeani Atlantik deri në Azi.

Ja disa nga gjërat që na kanë dhënë romakët:

- > Rugët e mira dhe të drejta, që lidhnin të gjitha pjesët e perandorisë;
- > Shtëpitë e bukura me oborre dhe me dysheme në formë mozaiku;
- > Urat dhe ujësjellësat e fortë (për bartjen e ujit në largësi të mëdha);
- > Kubetë me maja të rrumbullakta, që i bënin ndërtesat më të forta dhe më të qëndrueshme;
- > Materialet e reja të ndërtimit, siç janë çimentoja dhe betoni;
- > Armët e reja, siç janë katapultet;
- > Shkrimtarët e mëdhenj, siç kanë qenë Ciceroni dhe Virgjili;
- > Sistemin romak të së drejtës, të cilin e përdorin edhe sot shumë vende europiane.



Një ujësjellës romak që qëndron ende sot, Pont du Gard në Francë

Mozaikët janë bërë duke përdorur pjesë të vogla të gurit, smaltit, qelqit ose të qeramikës dhe janë përdorur për të dekoruar ndërtesat.

Mesjeta


përafërsisht prej vitit 500 deri në vitin 1500 (e.r.)

Pas rënimit të perandorisë romake, pjesë të ndryshme të Europës u morën nga popuj të ndryshëm. Për shembull...



Keltët

Para periudhës romake keltët jetuan në shumë pjesë të ndryshme të Europës. Sot pasardhësit e tyre jetojnë në Bretanjë (Francë), Kornual (Angli), Galicia (Spanjë), Irlandë, Skoci dhe Uells. Në këto pjesë të Europës gjuhët dhe kultura kelte janë ende te gjalla.



Popujt gjermanikë

Jo të gjithë u vendosen në Gjermani:


- > anglët dhe saksonët u vendosen në Angli dhe sunduan deri në vitin 1066;
- > frankët midis viteve 500 – 800 pushtuan një pjesë të madhe të Europës, duke përfshirë Francën. Mbreti më i famshëm i tyre ka qenë Sharlemani (Charlemagne);
- > gotët (vizigotët dhe ostrogotët) krijuan mbretëritë në Spanjë dhe Itali;
- > vikingët jetuan në Skandinavi. Në vitet 800 dhe 900 ata lundruan në vende të tjera, duke vjedhur thesarë, duke tregtuar dhe duke u vendosur aty ku kishte toka të mira për bujqësi e blegtori.

Vikingët ishin aq detarë të mirë sa mbërritën edhe në Amerikë (por nuk i thanë askujt).



Normanët

Apo 'Njerëzit e veriut', ishin vikingët që u vendosen në Francë (në zonën që quhet Normandi) dhe në vitin 1066 pushtuan Anglinë. Një tekstil e famshme normane tregon skena nga ky pushtim. Kjo tekstil ruhet në muzeun e qytetit Bajo (Bayeux).





Kështjellat mesjetare u ndërtuan për të mbajtur armiqtë jashtë.


Sllavët u vendosën në shumë pjesë të Europës lindore dhe ishin paraardhësit e popujve të sotëm që flasin gjuhët sllave, ku përfshihen bjellorusët, bullgarët, kroatët, çekët, polakët, rusët, serbët, sllovakët, sllovenët dhe ukrainasit.

Pas vendosjes së **magjarëve** në bazenin e Karpateve në shekujt 9 dhe 10, në vitin 1000 u themelua Mbretëria e Hungarisë. Pasardhësit e tyre sot jetojnë në Hungari dhe në vendet e tjera fqinjë.

Gjatë mesjetës në Europë, mbretërit dhe fisnikët shpesh janë grindur dhe kanë pasur luftëra të shpeshta (këto kanë qenë kohët kur kalorësit luftonin me parzmorë). Për t'u mbrojtur nga sulmet, mbretërit dhe fisnikët shpesh kanë jetuar në kështjella të fortifikuara mirë, me mure të trashë prej guri. Disa kështjella kanë qenë aq të forta sa që kanë mbijetuar edhe sot e kësaj dite.



Arkitektura "Gotike" ishte një shpikje e madhe e Mesjetës. Kjo është një statujë "kokë ulluku" në Katedralën e Milanos.



Gjatë mesjetës krishtërimi u bë feja kryesore në Europë dhe kishat u ndërtuan pothuajse gjithkund. Disa prej tyre janë shumë mbresëlënëse, veçanërisht katedralet e mëdha, me kupolat e tyre të larta dhe dritaret e ngjyrosura.

Priftërinjtë merreshin me bujqësi dhe blegtori, dhe ndihmuan në zhvillimin e tyre në mbarë Europën. Ata gjithashtu hapen shkolla dhe shkruan libra. Manastiret e tyre shpesh kishin biblioteka, ku janë ruajtur libra të rëndësishëm që nga koha e antikitetit.

Në Spanjën jugore, ku islami ishte feja kryesore, sundimtarët ndërtuan xhami dhe minare të bukura. Më të famshmet që kanë mbetur deri në ditët e sotme janë xhamia në Kordobë dhe ajo Giralda, në Sevilë.



Pamja e xhamisë së madhe mesjetare në Kordoba (Spanjë).



Rilindja

përafërsisht prej vitit 1300
deri në vitin 1600 (e.r.)

Gjatë mesjetës, shumica e njerëzve nuk kanë ditur të shkruajnë apo të lexojnë, dhe kanë ditur vetëm ato gjëra që i kishin mësuar në kishë. Vetëm manastiret dhe universitetet kishin kopjet e librave, të shkruara nga grekët dhe romakët e vjetër. Por në vitet 1300 dhe 1400, studentët filluan t'i rizbulojnë librat e vjetër. Ata u mrekulluan nga idetë dhe njohuritë e mëdha që gjetën aty dhe njohuritë filluan të përhapen.

Njerëzit e pasur dhe të shkolluar, për shembull në Firencë (Itali), ishin shumë të interesuar. Ata mund t'i blinin librat, sidomos kur u zbulua procesi i shtypjes së tyre në Europë (1445) dhe ranë në dashuri me Greqinë dhe Romën e vjetër. Ata filluan të modelojnë shtëpitë e tyre sipas pallateve të vjetra romake dhe të paguanin artistët e skulptorët e talentuar për t'i dekoruar ato me skenat e rrëfimeve greke e romake, si dhe me statuja të zotave, heronjve dhe të perandorëve.

Një nga statujat më të famshme të botës, Davidi nga Mikelanxhelo.


Leonardo da Vinçi skicoi këtë 'helikopter' 500 vjet më parë!



Një nga pikturat më të mira të Rilindjes, Venus nga Botiçeli.

Dukej sikur u ringjall bukuria dhe dituria e humbur e botës. Për këtë arsye, kjo periudhë quhet Rilindje. Kjo periudhë i dha botës:

- > Piktoret dhe skulptorët e mëdhenj, siç janë Mikelanxhelo dhe Botiçelli;
- > Arkitektët e talentuar, siç ishte Bruneleski;
- > Zbuluesin dhe artistin e mrekullueshëm, Leonardo da Vinçi;
- > Mendimtarët e mëdhenj, siç ishin Tomas Mor, Erasmus dhe Montenji;
- > Shkencëtarët, siç ishin Koperniku dhe Galileu (i cili zbuloi se Toka dhe planetët e tjera sillen rreth Diellit);
- > Ndërtesat e bukura, siç janë kështjellat në Luginën Luare;
- > Interesimin për atë se çka mund të arrijnë qeniet njerëzore.




Revolucioni industrial

përafërsisht prej vitit 1750 deri në 1880 (e.r.)

Para rreth 250 vitesh në Europë filloi një lloj tjetër revolucion në botën e 'industrialisë'. Ai filloi me krizën e energjisë. Për katër mijë vjet njerëzit kanë djegur dru dhe qymyr. Por në këto vite disa në disa pjesë të Europës po u mbaronin sipërfaqet me pyje. Çfarë lëndë djegëse tjetër do të mund të përdorej?

Përgjigja ishte, qymyri. Në Europë kishte shumë qymyr, kështu që minatorët filluan ta nxjerrin atë. Makinat e sapozbuluara me avull punonin me qymyr. Kjo lëndë djegëse mund edhe të përpunohej dhe të shndërrohej në koks, një lëndë djegëse shumë më e pastër dhe ideale për prodhimin e hekurit dhe çelikut.

Rreth 150 vite më parë, një anglez i quajtur Henri Besemer (Henry Bessemer) zbuloi 'furnaltën', që mund të prodhonte sasi të mëdha çeliku me një kosto të vogël prodhuese. Nuk kaluan shumë kohë dhe Europa prodhonte sasi më të mëdha të çelikut, duke ndryshuar kështu botën. Çeliku i lirë bëri të mundshëm ndërtimin e grataçelave, urave të mëdha, anijeve transoqeanike, veturave, frigoriferëve, por edhe të armëve e bombave.



*Henri Besemer,
shpikësi i përpunimit
modern të çelikut.*



Zbulime të mëdha dhe ide të reja

përafërsisht prej vitit 1500 deri në vitin 1900 (e.r.)



© E. Benjamini Andrews

Kopjet e anijeve të Kristofor Kolombos.



© G. Paganini Lopez

Vasko de Gama – njeriu i parë që udhëtoi nga Europa në Indi.



Wikimedia

Dodo, një zog jofluturues, dikur jetonte në një ishull në Oqeanin Indian. Ai shkoi drejt zhdukjes nga kolonizatorët evropianë.



© Catherine Lusurier

Volter, një nga shkrimtarët më të mëdhenj të kohës së Iluminizmit.


Në kohën e Rilindjes, tregtia me vendet e largëta po bëhej gjithnjë e më e rëndësishme për tregtarët evropianë. Për shembull, ata shisnin mallra në Indi dhe sillnin erëza të dobishme e gurë të çmuar. Mirëpo, udhëtimi ishte i vështirë dhe merrte shumë kohë, kështu që tregtarët dëshironin të arrinin në Indi përmes rrugëve detare. Problemi këtu ishte se kontinenti i Afrikës ishte pengesë, madje shumë e madhe!

Megjithatë, nëse bota me të vërtetë ishte e rumbullaktë (siç kishin filluar të besonin njerëzit), anijet evropiane do të mund të arrinin në Indi duke lundruar nga perëndimi. Kështu, në vitin 1492, Kristofer Kolombo (Christopher Columbus) dhe marinarët e tij u nisën nga Spanja dhe kaluan oqeanin Atlantik, por në vend që të shkonin në Indi, ata zbuluan ishujt Bahamas (në detin e Karaibeve, afër brigjeve të Amerikës).

Nuk kaloi shumë kohë dhe zbulues të tjerë filluan gjithashtu udhëtimet e tyre. Në vitet 1497-98, Vasko da Gama, oficer portugez i marinës, ishte evropiani i parë që arriti në Indi duke lundruar përrreth Afrikës. Në vitin 1519, një zbulues tjetër portugez, Ferdinand Magelani, në emër të mbretit të Spanjës, udhëhoqi ekspeditën e parë evropiane që lundroi rreth botës.

Pa kaluar shumë kohë, evropianët kishin zbuluar ishujt Karaibe dhe Amerikën, të cilën e quajtën 'Bota e Re', duke themeluar koloni në këto vende. Kjo do të thotë se, ata zotëruan tokën e këtyre vendeve duke deklaruar se tani ajo i takonte vendit të tyre përkatës në Europë. Ata çuan besimet, traditat dhe gjuhën e tyre, dhe për këtë arsye gjuha angleze dhe ajo frënge u bënë gjuhët kryesore në Amerikën e Veriut, ndërsa gjuha spanjolle dhe portugeze në Amerikën Qendrore dhe atë Jugore.

Me kalimin e kohës, evropianët lundruan gjithnjë e më larg për të arritur në Kinë, Japoni, Azinë juglindore, Australi dhe Oqeani. Marinarët që ktheheshin nga këto toka të largëta deklaruan të kishin parë krijesa të çuditshme që dallonin shumë nga ato në Europë. Kjo i nxiti shkencëtarët të hulumtojnë këto vende dhe t'i sjellin këto shtazë dhe bimë në muzetë e Europës. Gjatë shekullit të 19-të, zbuluesit evropianë shkuan në vise të thella të Afrikës, dhe deri në vitin 1910 vendet evropiane kishin kolonizuar pjesën më të madhe të kontinentit të Afrikës.



Ndërkohë, në Europë, shkencëtarët po kuptonin gjithnjë e më shumë se si funksionon gjithësia. Gjeologët që studionin shkëmbinjtë dhe fosilet, filluan të jenë kureshtarë se si është formuar toka dhe sa e vjetër është ajo. Dy shkencëtarët e mëdhenj, Zhan-Baptist-Lamarck (Jean-Baptiste Lamarck) në Francë dhe Çarls Darvin (Charles Darwin) në Angli arritën në përfundim se shtazët dhe bimët kishin evoluar, duke u ndryshuar nga një lloj në një lloj tjetër me kalimin e miliona, miliona vjetëve.


Gjatë shekullit të 18-të, njerëzit filluan të parashtronin pyetje të tjera të rëndësishme, siç janë: mënyra se si duhet të qeverisen vendet dhe cilat të drejta dhe liri duhet të gëzojnë njerëzit. Shkrimtari Zhan Zhak Ruso (Jean-Jacques Rousseau) tha se të gjithë duhet të jenë të barabartë. Një shkrimtar tjetër, Volteri (Voltaire), tha se bota do të ishte më e mirë nëse arsyeja dhe dituria do të zëvendësonin mosdijen dhe bestytnitë.

Kjo kohë e ideve të reja, e quajtur 'lluminizëm' solli ndryshime të mëdha në disa vende, si për shembull, revolucionin francez të vitit 1789, kur populli vendosi se nuk do të sundohej më nga mbretërit dhe mbretëreshat. Një nga sloganet e tyre revolucionarë ishte "liri, barazi dhe vëllazëri", që përfundimisht u bë slogan kombëtar francez.

Bota moderne

përafërsisht prej vitit 1880 deri më sot

Zbulimet e tjera europiane nga shekujt 19 dhe 20 kanë ndihmuar në krijimin e botës që sot njohim.



1886 *Motori me djegie të brendshme*

1901 *Lajmet e para përmes radios*

1909 *Bakeliti, plastika e parë*

1912 *Dritat e neonit*

1920s *Televizori dhe autostradat*

1935 *Radari dhe stilolapsi*

1937 *Kafeja e çastit*

1939 *Aeroplani i parë me motor reaktiv*

1940s *Kompjuteri i parë*

Sot, rreth një e katërta e njerëzve që punojnë në Europë prodhojnë mallrat që janë të nevojshme për botën moderne: ushqime, pije, telefona celularë, kompjutera, veshmbathje, mobilje, lavatriçe, televizorë, vetura, autobusë, kamionë, si dhe shumë prodhime të tjera.

Rreth 7 nga çdo 10 punëtorë europianë punojnë në sektorin e shërbimeve. Me fjalë të tjera, ata punojnë në dyqane, posta, banka, kompani të sigurimeve, hotele, restorante, spitale, shkolla, etj., qoftë duke shitur apo duke ofruar shërbime të nevojshme për popullatën.



© Julia Margaret Cameron

© Zubro/Wikimedia

Çarls Darvini publikoi teorinë e tij të evolucionit në 1859.

Telefoni i parë, i shpikur nga një scocez, Aleksandër Graham Bel. Sot, Europa prodhon telefona celularë të tipit të fundit.

Mësimet e nxjerra nga historia

Fatkeqësisht, historia e Europës nuk ka të bëjë vetëm me arritjet e mëdha, për të cilat mund të krenohemi. Ekzistojnë shumë gjëra për të cilat duhet të turpërohemi. Gjatë shekujve të kaluar, kombet europiane kanë bërë luftëra të tmerrshme kundër njëri-tjetrit. Këto luftëra zakonisht zhvilloheshin për pushtet, prona dhe në baza fetare.

Kolonizatorët europianë kanë vrarë miliona njerëz autoktonë në kontinente të tjera, duke luftuar me ta apo duke i keqtrajtuar ose duke përhapur padashje sëmundjet nga Europa. Po ashtu, europianët morën miliona afrikanë për të punuar si skllëvër.

Nga këto të këqija është dashur të nxirreshin mësimet. Tregtia e skllëvërve në Europë është ndaluar në vitet 1800. Kolonitë fituan lirinë e tyre në vitet 1900 dhe paqja më në fund erdhi edhe në Europë.

Për të parë si ndodhi kjo, lexoni kapitullin 'Bashkimi i familjes: historia e Bashkimit Europian'.

Lufta

Fatkeqësisht, familja europiane ka pasur mosmarrëveshje të shumta. Në pjesën më të madhe të rasteve ato kishin të bënin me atë se kush duhet të sundojë vendin apo cili vend ishte pronar i cilit territor. Nganjëherë sunduesi dëshironte të fitonte më shumë pushtet, duke pushtuar fqinjët e vet dhe dëshironte të dëshmonte se populli i tij ishte më i fortë dhe më i mirë se popujt e tjerë.

Sido që të jetë, Europa ka përjetuar luftëra të tmerrshme gjatë qindra viteve të kaluara. Në shekullin e 20-të në këtë kontinent filluan dy luftëra të mëdha, të cilat u përhapen në mbarë botën. Për këtë arsye edhe u quajtën luftëra botërore. Në këto luftëra u vranë miliona njerëz, duke lënë Europën të varfër dhe në rrënoja.

A mund të bëhet diçka që këto gjëra të mos ndodhin më? A do të mësohen ndonjëherë europianët që të ulen së bashku dhe të diskutojnë në vend se të luftojnë?

Përgjigja është 'po'.

Kjo është edhe tema e kapitullit tonë të ardhshëm: Historia e Bashkimit Europian.



...dhe paqja


Ne europianët u përkasim shumë vendeve të ndryshme, me gjuhë, tradita, zakone dhe besime të ndryshme. Por, nga ana tjetër, ne i përkasin njëri-tjetrit, si një familje e madhe. Kjo ndodh për shkak të shumë arsyeve.

Këtu do të paraqesim disa prej tyre:

- > Ne kemi jetuar së bashku në këtë kontinent me mijëra vjet;
- > Gjuhët tona në të shumtën e rasteve janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën;
- > Shumë popuj në çdo vend janë pasardhës të popujve nga vende të tjera;
- > Traditat, zakonet dhe festivalet tona shpesh kanë prejardhje të njëjtë;
- > Ne kemi të përbashkët dhe kënaqemi me muzikën dhe artin e bukur, si dhe me shumë drama e rrëfime, që popujt nga mbarë Europa kanë shkëmbyer mes tyre gjatë shekujve;
- > Pothuajse çdokush në Europë beson në gjërat, siç janë drejtësia, marrëdhëniet e mira fqinjësore, liria e mendimit, respekti për njëri-tjetrin dhe kujdesi për personat në nevojë;
- > Pra, ne kënaqemi me atë çka kemi të veçantë në vendin dhe rajonin tonë, por gjithashtu kënaqemi me ato që kemi të përbashkëta si europianë.

Historia e Bashkimit European

Lufta e dytë botërore përfundoi në vitin 1945. Kjo luftë, e cila filloi në Europë, solli shkatërrime e vrasje të tmerrshme. Si do të mund të parandalonin udhëheqësit e Europës ngjarje të ngjashme në të ardhmen? Në këtë aspekt, atyre u nevojitej një plan i mirë-studiuar që nuk ishte provuar asnjëherë më parë.



Robert Shuman.



Zhan Mone.

Një ide plotësisht e re


Një francez, i quajtur Zhan Mone (Jean Monnet) kishte menduar shumë për këtë. Ai kuptoi se ekzistojnë dy gjëra që i nevojiteshin një vendi para se të niste luftën: hekuri për prodhimin e çelikut (nga i cili do të prodhoheshin tanke, armatime, bomba, etj) dhe qymyri për prodhimin e energjisë të nevojshme për fabrika dhe hekurudha. Europa zotëronte sasi të bollshme të qymyrit dhe çelikut dhe për këtë arsye vendet europiane e kishin të lehtë të prodhonin armatime dhe të hynin në luftë.

Kështu që Zhan Mone doli me një ide shumë të guximshme. Ideja e tij ishte që qeveria e Francës dhe ajo e Gjermanisë, dhe ndoshta edhe ato të vendeve të tjera europiane, nuk duhet të administrojnë më industritë e tyre të qymyrit dhe çelikut, por këto industri do të duhej të organizoheshin nga popujt e të gjitha vendeve të përfshira, ata do të ulëshin në tavolinë dhe do t'i diskutonin gjërat dhe do të vendosnin së bashku. Për këtë arsye lufta midis tyre do të ishte e pamundur.

Zhan Mone mendoi se plani i tij do të funksiononte vetëm nëse udhëheqësit europianë do të kishin vullnet të bashkëpunonin dhe ta provonin. Ai foli për këtë plan me mikun e tij Robert Shuman, i cili ishte ministër në qeverinë e Francës. Robert Shuman mendoi se kjo ishte një ide e mrekullueshme dhe më 9 maj të vitit 1950 e shpalli atë në një fjalim të rëndësishëm.

Ky fjalim jo vetëm që bindi udhëheqësit francezë dhe gjermanë, por edhe udhëheqësit e Belgjikës, Italisë, Luksemburgut dhe të Holandës. Të gjithë këto shtete vendosen që t'i bashkojnë industritë e tyre të qymyrit dhe çelikut dhe ta formonin një klub, që ata e quajtën Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut (ECSC/KEQÇ). Ky Komunitet do të funksiononte për qëllime paqësore dhe do të ndihmonte në rindërtimin e Europës nga rrënojat e luftës. KEQÇ u themelua në vitin 1951.





Të mërzhitur në kufi... radhë si kjo kanë qenë pjesë e jetës normale në Europë.

Tregu i përbashkët

Të gjashtë vendet punonin aq mirë së bashku saqë shumë shpejt vendosën të themelonin një klub tjetër të quajtur Komuniteti Ekonomik European (EEC/KEE), i cili u krijua në vitin 1957.

Një nga idetë kryesore ishte që vendet e KEE të kishin një treg të përbashkët për ta bërë më të lehtë tregëtinë e tyre. Deri atëherë kamionët ,trenat apo anijet që transportonin mallra nga njëri vend në tjetrin duhet të ndalonin gjithnjë në kufi, ku kontrolloheshin dokumentet dhe bëheshin pagesat për të ashtuquajturat 'detyrime doganore'. Kjo ishte një pengesë dhe i bënte mallrat nga jashtë më të shtrenjta.

Ideja për të pasur një treg të përbashkët synonte mënjanimin e të gjitha kontrolleve doganore dhe vonesave të pagesave doganore dhe mundësimin e vendeve për të bërë tregëti me njëri-tjetrin sikur ato të ishin të gjithë nga i njëjti vend.

Ushqimi, bujqësia dhe blegtoia

Lufta e Dytë Botërore e vështirësoi shumë për Europën prodhimin e ushqimit apo importimin e tij nga kontinente të tjera. Europës i mungonte ushqimi edhe në fillim të viteve 50-të . Kështu që KEE vendosi të financoje fermerët për të prodhuar më shumë ushqime dhe për të bërë kështu që ata të sigurojnë një jetë më të mirë nga toka.

Ky rregullim u quajt 'politika e përbashkët bujqësore' (CAP/PPB). Ajo funksionoi mirë. Në fakt funksionoi aq mirë saqë fermerët prodhuan ushqime me tepicë dhe kjo politikë duhej të ndryshohej! Sot sipas kësaj politike përsëri fermerët financohen për t'u kujdesur për fshatin.



Makina si kjo përdoren për korren e grurit dhe kulturave të tjera.

Nga KEE deri te Bashkimi European

Tregu i përbashkët shumë shpejt filloi t'ua lehtësojë jetën njerëzve në KEE.

Ata filluan të kenë më shumë para për të shpenzuar, më shumë ushqim për të ngrënë dhe më shumë mallra të ndryshme nëpër dyqane. Kjo ndodhi edhe në vendet e tjera fqinje, kështu që në vitin 1960 disa nga këto vende filluan të pyesnin nëse edhe ato do të mund t'i bashkëngjiteshin këtij klubi.

Pas disa viteve diskutimesh, Mbretëria e Bashkuar, Danimarka dhe Irlanda iu bashkuan këtij klubi në vitin 1973. Ndërsa në vitin 1981 i erdhi radha Greqisë, e cila u pasua nga Portugalia dhe Spanja në vitin 1986, si dhe nga Austria, Finlanda e Suedia në vitin 1995.

Në këtë moment ky klub kishte 15 shtete.


Gjatë këtyre viteve, klubi po ndryshohej. Deri në fund të vitit 1992, kishte krijuar një treg të vetëm, por përveç kësaj, po bënte edhe shumë gjëra të tjera. Për shembull, vendet e KEE-së po bashkëpunonin për mbrojtjen e mjedisit, ndërtimin e rrugëve dhe hekurudhave më të mira në mbarë Europën. Vendet më të pasura ndihmuan ato më të varfra për ndërtimin e rrugëve të tyre dhe për projekte të tjera të rëndësishme.

Me qëllim lehtësimin e udhëtimit, shumica e vendeve të KEE-së i hoqën kontrollet e pasaportave në kufi. Një person që jetonte në një shtet anëtar ishte i lirë të shkonte dhe të jetonte e të punonte në cilindo shtet tjetër anëtar. Qeveritë e këtyre vendeve po diskutonin edhe ide të tjera, si për shembull, mënyrën se si policët nga vende të ndryshme do të mund të ndihmonin njëri-tjetrit në kapjen e kriminelëve, trafikantëve të drogës dhe terroristëve.


E thënë shkurt, klubi dallonte shumë dhe ishte shumë më tepër i bashkuar në vitin 1992, kështu që vendosi ta ndryshojë emrin në Bashkim European (BE).

Mbrojta e mjedisit përfshin pakësimin e ndotjes së ajrit, si për shembull, duke përdorur energjinë e erës për prodhimin e rrymës elektrike.

Një polic dhe qeni i tij kontrollojnë bagazhin për drogë.



Bashkimi me klubin. Në këtë foto Greqia nënshkruan anëtarësimin.



Bashkimi i familjes

Ndërkohë, jashtë kufijve të BE-së po ndodhnin gjëra interesante. Shumë vite me radhë, pjesa lindore dhe perëndimore e Europës kanë qenë të ndara. Ato nuk ishin në luftë, por udhëheqësit e tyre kishin mospajtime të mëdha. Sundimtarët e pjesës lindore besonin në sistemin e qeverisjes të quajtur komunizëm, i cili nuk u jepte njerëzve shumë liri. Për shkak të mënyrës së qeverisjes, këto vende ishin të varfra në krahasim me Europën Perëndimore.

Ndarja mes lindjes dhe perëndimit ishte aq e madhe sa që shpesh përshkruhej si një perde e hekurt. Në shumë vende kufiri ishte krijuar me gardhe apo me mure të lartë, sikurse ai i qytetit të Berlinit që ndante Gjermaninë në dy pjesë. Marrja e lejes për kalimin e këtij kufiri ka qenë shumë e vështirë.

Më në fund, në vitin 1989, ndarja dhe mosmarrëveshjet përfunduan. Muri i Berlinit u rrëzua, dhe perdja e hekurt u shëmb dhe pak kohë më pas edhe Gjermania u ribashkua. Popujt e Europës qendrore e lindore zgjodhën vetë qeveritë e tyre dhe e flakën sistemin e vjetër e të rreptë komunist. Më në fund ishin të lirë! Këto ishin kohëra të mrekullueshme për të festuar.

Rrëzimi i murit të Berlinit, në vitin 1989.



Vendet që kishin fituar lirinë filluan të pyesnin nëse do të mund t'i bashkoheshin Bashkimit European, kështu që shumë shpejt u formua grupi i vendeve candidate që prisnin të bëheshin anëtare të BE-së.

Një vend para se t'i bashkohet Bashkimit European duhet të ketë një ekonomi funksionale. Po ashtu, ai duhet të jetë një vend demokratik, me fjalë të tjera, populli i tij duhet të jetë i lirë të zgjedhë atë që dëshiron ta udhëheqë, dhe të respektojë të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut përfshijnë të drejtën për të thënë atë që mendon, të drejtën për të mos u burgosur pa një gjykim të drejtë, të drejtën për të mos u torturuar, si dhe shumë të drejta të tjera të rëndësishme.

Ish-vendet komuniste punuan shumë në të gjitha këto drejtime, dhe pas ca vitesh, tetë prej tyre ishin të gatshme për t'u anëtarësuar në BE: Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia.

Ato iu bashkuan BE-së më 1 maj 2004, së bashku me dy ishuj mesdhetarë, Qipro dhe Malta. Më 1 janar 2007, edhe dy shtete të tjera ish-komuniste, Bullgaria dhe Rumania, iu bashkuan grupit. Në 1 korrik 2013 Kroacia u bë shteti i 28-të anëtar i Bashkimit European.

Asnjëherë më parë kaq shumë shtete **nuk** ishin bashkuar BE-së në një periudhë kaq të shkurtër kohore. Kjo përbën një ribashkim të vërtetë familjar, që ka bashkuar pjesët lindore, qendrore dhe perëndimore të Europës.



Flamujt e 28 vendeve anëtare të BE-së.

Çfarë bën BE-ja

BE-ja përpiqet ta përmirësojë jetën në të gjitha mënyrat.
Këtu do gjeni disa prej tyre.



*Ndotja kalon kufijtë
kështu që shtetet europiane
punojnë së bashku për të
mbrojtur mjedisin.*

Ndryshimet klimatike dhe mjedisi

Mjedisi u përket të gjithëve, kështu që vendet e ndryshme duhet të bashkëpunojnë në mbrojtjen e tij. BE-ja ka rregulla për ndalimin e ndotjes dhe për mbrojtjen (për shembull) të zogjve të egër. Këto rregulla vlejnë në të gjitha vendet e BE-së, dhe qeveritë e tyre duhet të sigurohen që ato rregulla të respektohen.

Ndryshimet klimatike, të njohura si 'ngrohja globale', janë një problem tjetër, me të cilin vendet nuk mund të ballafaqohen veç e veç. Rrjedhimisht, vendet e BE-së janë pajtuar të bashkëpunojnë në zvogëlimin e emetimeve të gazrave ndotëse që shkaktojnë ngrohjen globale. BE-ja gjithashtu përpiqet të ndikojë tek vendet e tjera që të bëjnë të njëjtën gjë.



*Euro përdoret
në shumë shtete
të BE-së.*



Euro

Gjatë viteve të kaluara, secili vend i Europës ka pasur monedhën e vet. Tani ekziston një monedhë e vetme, euro, të cilën mund ta kenë të gjitha vendet e Europës nëse dëshirojnë. Një monedhë e vetme e bën biznesin më të lehtë, si dhe udhëtimin e blerjet në mbarë BE-në, pa pasur nevojë të këmbehen monedhat nga njëra në tjetrën.

Për futjen e euros u deshën nëntë vjet punë dhe një planifikim i kujdesshëm. Sot, më shumë se dy të tretat e qytetarëve të BE-së përdorin euron në vend të monedhave të tyre të vjetra. Nëse i krahasoni monedhat e euros, do të shihni se në njërin anë është vizatimi që përfaqëson vendin ku është shtypur, ndërsa ana tjetër është e njëjtë për të gjitha vendet.



*Studentë nga vende
të ndryshme studiojnë
së bashku, me ndihmën
e BE-së.*

Liria!

Njerëzit në BE janë të lirë të jetojnë, punojnë apo të studiojnë në cilindo shtet të BE-së, dhe BE-ja është duke bërë çdo gjë që është e mundur për ta thjeshtësuar lëvizjen nga një vend në tjetrin. Kur kalon kufirin në shumicën e vendeve të BE-së nuk ka nevojë për pasaportë. BE-ja inkurajon studentët dhe të rinjtë që të kalojnë një periudhë studimesh apo trajnimesh në një vend tjetër europian.



© Javier Lareca/Mon Parys

Trajnimi i njerëzve për të marrë një profesion të ri është shumë i rëndësishëm.

Punësimi

Është e rëndësishme që njerëzit të jenë të punësuar aty ku u pëlqen dhe aty ku mund t'i tregojnë aftësitë e tyre. Disa nga paratë që fitojnë shkojnë për spitale dhe shkolla, si dhe për kujdesin ndaj të moshuarve. Për këtë arsye BE-ja po bën çdo gjë që është e mundur për të krijuar vende të reja dhe më të mira pune për secilin që mund të punojë. Kjo u ndihmon njerëzve të krijojnë biznese të reja dhe ofron fonde për aftësimin e tyre për lloje të reja të punëve.




© Stephen Mawsey/Mon Parys

BE-ja ndihmon për të hapur rrugë të reja.

Ndihma për rajonet në vështirësi

Jeta nuk është e lehtë për të gjithë ata që jetojnë në Europë. Në disa shtete nuk ka mjaft vende pune, sepse minierat dhe fabrikat janë mbyllur. Në disa zona, marrja me bujqësi e blegtori është e vështirë për shkak se nuk ka rrugë apo hekurudha të mjaftueshme.

BE-ja i trajton këto probleme, duke grumbulluar para nga të gjithë shtetet e saj anëtarë dhe duke i përdorur ato për të ndihmuar rajonet që kanë vështirësi. Për shembull, ndihmon në ndërtimin e rrugëve dhe hekurudhave të reja, si dhe bizneset për të krijuar vende të reja pune.



© Annie Griffiths-Bell/Corbis

BE-ja shpërndan ushqim për njerëzit në nevojë.

Ndihma për vendet e varfra

Në shumë vende të botës njerëzit po vdesin apo kanë jetë të vështirë për shkak të luftës, sëmundjeve dhe katastrofave natyrore, siç janë thatësitrat ose përmbytjet. Shpesh këto vende nuk kanë para të mjaftueshme për të ndërtuar shkolla dhe spitale, rrugë dhe shtëpi, për të cilat kanë nevojë qytetarët e tyre.

BE-ja u jep fonde këtyre vendeve dhe dërgon mësues, mjekë, inxhinierë dhe ekspertë të tjerë për të punuar atje. BE-ja po ashtu blen shumë gjëra që këto vende prodhojnë pa taksa doganore. Në këtë mënyrë, vendet e varfra mund të fitojnë më shumë para.



Flamuri i Bashkimit Europian.

Paqja

Bashkimi Europian ka bashkuar shumë shtete europiane si miq. Natyrisht, ato nuk pajtohen gjithmonë për çdo gjë, por në vend që të luftojnë, udhëheqësit e tyre ulen rreth një tavoline për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre.

Pra, ëndrra e Zhan Monesë dhe e Robert Shumanit u bë realitet.

BE-ja ka sjellë paqen mes anëtarëve të saj. Po ashtu, është duke punuar për një paqe afatgjatë mes fqinjëve të vet dhe në mbarë botën. Për shembull, ushtarët dhe policët e BE-së ndihmojnë në ruajtjen e paqes në ish-Jugosllavi, ku kanë ndodhur luftëra të tmerrshme jo shumë vite më parë.

Këto janë vetëm disa prej aktiviteteve të BE-së, por ka edhe shumë të tjera. Në fakt, të qenit anëtar i BE-së krijon dallimin në pothuajse çdo aspekt të jetës sonë. Çfarë duhet apo nuk duhet të bëjë BE-ja? Për këtë vendosin qytetarët e BE-së. Si mund të bëjmë zërin tonë të dëgjohet? Këtë mund ta gjeni në kapitullin e ardhshëm.

Europa ka flamurin dhe himnin e vet, 'Oda e Gëzimit' nga simfonia e nëntë e Bet'hovenit. Fjalët origjinale janë në gjuhën gjermane, por kur përdoret si himn europian nuk ka fjalë, është vetëm melodi. Këtë himn mund ta dëgjoni në faqen e internetit:

europa.eu/abc/symbols/anthem/index_en.htm

BE-ja dhe fqinjët e saj

► Bashko kryeqytetet me shtetet e tyre ?

- 1 Bruksel
- 2 Sofie
- 3 Pragë
- 4 Kopenhagë
- 5 Berlin
- 6 Talin
- 7 Dublin
- 8 Athinë
- 9 Madrid
- 10 Paris
- 11 Zagreb
- 12 Romë
- 13 Nikozi
- 14 Rigë
- 15 Vilnius
- 16 Luksemburg
- 17 Budapest
- 18 Valetë
- 19 Amsterdam
- 20 Vienë
- 21 Varshavë
- 22 Lisbonë
- 23 Bukuresht
- 24 Ljubljanë
- 25 Bratisllavë
- 26 Helsinki
- 27 Stokholm
- 28 Londër

Legjenda:

Vendet e ngjyrosura janë anëtare të Bashkimit Europian (BE).

Vendet me vija planifikohet t'i bashkohen BE-së.

Vendet e tjera, duke përfshirë edhe ato të shënuara me një rreth të vogël të bardhë, janë fqinjë të BE-së.



Pikat tregojnë ku janë kryeqytetet.

Vatikani gjendet në Romë.

Disa ishuj dhe territore që i përkasin Francës, Portugalisë dhe Spanjës janë pjesë të BE-së, por janë shumë larg kontinentit të Europës, kështu që i kemi vendosur në kuti (në pjesën e sipërme të djathtë).

(*) UNSCR 1244





Lista e disa objekteve të famshme europiane:

- 1 Atomium, Bruksel, Belgjikë
- 2 Stonehenge, Wiltshire, Mbretëria e Bashkuar
- 3 Manastiri Mbretëror i San Lorenzo de El Escorial, Madrid, Spanjë
- 4 Partenoni, Athinë, Greqi
- 5 Godina e Parlamentit në Budapest, Hungari
- 6 Kulla Eiffel, Paris, Francë
- 7 Mullinjtë e erës, Holandë
- 8 Ura Çarlz, Pragë, Republika Çeke
- 9 Statuja e Vogël Mermaid, Kopenhagë, Danimarkë
- 10 Kisha e Shën Nikolas-it, Sofie, Bullgari
- 11 Katedralia Familja e Shenjtë (Sagrada Familia) Barcelonë, Spanjë
- 12 Koloseu, Romë, Itali
- 13 Porta e Brandenburgut, Berlin, Gjermani

A mund të gjeni secilin prej tyre në hartën më poshtë?

Faqja e mëparshme mund t'ju ndihmojë!





Shtetet e Bashkimit European

Shtetet janë të paraqitura sipas rendit alfabetik, sipas mënyrës se si çdo vend quhet në gjuhën apo gjuhët e veta (Siç është paraqitur në kllapa).

Flamuri	Shteti	Kryeqyteti	Popullsia
	Belgjikë (Belgique/België)	Bruksel (Brussel/Bruxelles)	11.0 milion
	Bullgari (България/Bulgaria)	Sofie (София/Sofija)	7.3 milion
	Republika Çeke (Česká republika)	Pragë (Praha)	10.5 milion
	Danimarkë (Danmark)	Kopenhagen (København)	5.6 milion
	Gjermani (Deutschland)	Berlin (Berlin)	81.8 milion
	Estoni (Eesti)	Talin (Tallinn)	1.3 milion
	Irlandë (Éire/Ireland)	Dublin (Baile Atha Cliath/Dublin)	4.6 milion
	Greqi (Ελλάδα/Elláda)	Athinë (Αθήνα/Athinai)	11.3 milion
	Spanjë (España)	Madrid (Madrid)	46.2 milion
	Francë (France)	Paris (Paris)	65.4 milion
	Kroaci (Hrvatska)	Zagreb (Zagreb)	4.4 milion
	Itali (Italia)	Romë (Roma)	60.8 milion
	Qipro (Κύπρος/Kypros) (Kibris)	Nikozi (Λευκωσία/Lefkosia) (Lefkosa)	0.9 milion
	Letoni (Latvija)	Rigë (Riga)	2.0 milion
	Lituani (Lietuva)	Vilnius (Vilnius)	3.0 milion
	Luksemburg (Luxemburg)	Luksemburg (Luxemburg)	0.5 milion
	Hungari (Magyarország)	Budapest (Budapest)	10.0 milion
	Maltë (Malta)	Valetë (Valletta)	0.4 milion
	Holandë (Nederland)	Amsterdam (Amsterdam)	16.7 milion
	Austri (Österreich)	Vienë (Wien)	8.4 milion
	Poloni (Polska)	Varshavë (Warszawa)	38.5 milion
	Portugali (Portugal)	Lizbonë (Lisboa)	10.5 milion
	Rumani (România)	Bukuresht (București)	21.4 milion
	Sloveni (Slovenija)	Lubljanë (Ljubljana)	2.0 milion
	Sillovaki (Slovensko)	Bratisllavë (Bratislava)	5.4 milion
	Finlandë (Suomi/Finland)	Helsinki (Helsinki/Helsingfors)	5.4 milion
	Suedi (Sverige)	Stokholm (Stockholm)	9.5 milion
	Mbretëri e Bashkuar (*) (United Kingdom)	Londër (London)	63.0 milion

(*) Emërtimi i plotë i shtetit është 'Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës', por shkurtimisht, shumica e njerëzve e quajnë Britani, Mbretëri e Bashkuar apo MB.

Shifrat e popullsisë janë të vitit 2012.

Burimi: Eurostat

Ejani të zbulojmë Europën! Lojë

(Këshillë: përgjigjet për të gjitha pyetjet mund t'i gjeni në këtë broshurë)

1. Sa kontinente ka bota?

1.

?

2. Cilat janë dy qytetet që lidh tuneli Çanell?

2.

?

3. Si quhet fluturimi i zogjve në jug gjatë vjeshtës dhe kalimi i dimrit në vende më të nxehta?

3.

?

4. Si quhet procesi kur bujqit i ujin tokat e tyre nga ujërat tokësore apo nga lumenjtë?

4.

?

5. Përmendni një gjallesë të detit që mund të kultivohet.

5.

?

6. Ç'do të thotë demokraci?

6.

?

7. Cila lëndë djegëse e makinave me avull bëri të mundur revolucionin industrial?

7.

?

8. Cila ngjarje historike ndodhi në vitin 1789?

8.

?

9. Në cilën dekadë u zbulua kompjuteri?

9.

?

10. Sa shtete janë anëtare të Bashkimit Europian?

10.

?

11. Sa shpesh mbahen zgjedhjet në Europë?

11.

?

12. Ku gjendet Gjykata Europiane e Drejtësisë?

12.

?

Dëshironi të luani, të testoni njohuritë tuaja dhe të zbuloni Europën më tej?
Mund të hyni në faqen e internetit: europa.eu/europago/explore

Ministrat e të gjitha
qeverive të shteteve të
BE-së takohen për të
miratuar ligjet e BE-së.



Si merren vendimet në BE

Siç mund ta përfytyroni, organizimi dhe funksionimi i çdo gjëje në BE kërkon shumë përpjekje dhe shumë njerëz. Kush e bën këtë?

Komisioni Europian

Në Bruksel, 28 gra dhe burra (një nga çdo vend i BE-së) takohen çdo të mërkurë për të diskutuar aktivitetet e ardhshme. Këta njerëz caktohen nga qeveria e vendit përkatës, por miratohen nga Parlamenti Europian.








Ata quhen 'komisionerë' dhe përbëjnë bashkërisht Komisionin Europian. Puna e tyre është të mendojnë çfarë është më e mira për BE-në në tërësi, dhe të propozojnë ligje të reja për tërë BE-në. Gjatë punës së tyre, ata marrin ndihmë nga ekspertët, juristët, sekretarët, përkthyesit dhe kështu me radhë.

Pasi merren vesh se çfarë ligjesh do të propozojnë, ata e dërgojnë propozimin e tyre në Parlamentin Europian dhe në Këshillin e Bashkimit Europian.

Parlamenti Europian

Parlamenti Europian përfaqëson të gjithë popujt e BE-së. Ky Parlament çdo muaj mban një seancë kryesore në Strazburg (Francë) për të diskutuar ligjet e reja të propozuara nga Komisioni Europian. Nëse Parlamenti nuk pajtohet me propozimin, mund të kërkojë nga Komisioni që ta ndryshojë atë derisa Parlamenti të vendosë nëse ligji është i mirë dhe mund të miratohet.

Parlamenti Europian ka 766 deputetë. Deputetët zgjidhen çdo pesë vjet me zgjedhje, ku të gjithë qytetarët e BE-së me të drejtë vote kanë mundësinë të votojnë.





Këshilli European

Këtu mbledhen të gjithë udhëheqësit e vendeve të BE-së në një mbledhje të nivelit të lartë (samtit), për të biseduar si shkojnë punët në Europë dhe për të përcaktuar strategjinë e Europës. Ata nuk i diskutojnë çështjet me hollësi, por flasin për formulimin e ligjeve të reja.

Këshilli

Deputetët e Parlamentit European nuk janë të vetmit që vendosin për ligjet e BE-së. Këto ligje duhet të diskutohen edhe nga ministrat e qeverive të të gjitha vendeve të BE-së. Mbledhjet e ministrave quhen Këshilli i Bashkimit European.

Pas diskutimit të propozimit, Këshilli voton për të. Ekzistojnë rregulla për numrin e votave që ka secili vend dhe sa vota nevojiten për miratimin e një ligji. Në disa raste, në bazë të rregullave të parashikuara, thuhet se Këshilli duhet të jetë në pajtim të plotë.




Pasi Këshilli dhe Parlamenti të kenë miratuar ligjin e ri, qeveritë e shteteve të BE-së duhet ta respektojnë atë.



Gjykata e Drejtësisë

Nëse një vend nuk zbaton ligjin në mënyrën e duhur, Komisioni European e paralajmëron atë dhe Komisioni mund të ankohej edhe në Gjykatën e Drejtësisë në Luksemburg. Detyra e Gjykatës është të sigurohet që ligjet e BE-së të respektohen dhe të zbatohen në të njëjtën mënyrë nga çdo vend. Kjo Gjykatë ka nga një gjyqtar prej secilit vend.

Ekzistojnë edhe grupe të tjera (komisione të ekspertëve e kështu me radhë) që janë të përfshirë në vendimmarrje në BE, sepse është shumë e rëndësishme që këto vendime të jenë të drejta.



E nesërmja...

Një nga sfidat e Europës sot është se si të sigurohemi që të rinjtë të kenë punë dhe një të ardhme të mirë. Kjo nuk është e lehtë, sepse firmat europiane duhet të konkurrojnë me kompani të pjesëve të tjera të botës që mund të jenë në gjendje ta kryejnë të njëjtën punë më lirë.




Sot ekzistojnë probleme të tjera të mëdha, të cilat mund të trajtohen vetëm nëse të gjitha vendet e botës bashkëpunojnë për të përmirësuar:

- > Ndotjen dhe ndryshimet klimatike;
- > Urinë dhe varfërinë;
- > Krimin dhe terrorizimin ndërkombëtar.

Bashkimi European është duke punuar për zgjidhjen e këtyre problemeve, por nuk është gjithmonë e lehtë për 28 qeveri dhe për Parlamentin European që të arrijnë të pajtohen për atë që duhet bërë. Ndërlíkimi i rregullave të vendimmarrjes në BE nuk ndihmon në këtë aspekt.

Për më tepër, njerëzit mendojnë se vetëm votimi i deputetëve të tyre një herë në pesë vite nuk u jep atyre shumë qasje në vendimmarrje në Bruksel apo në Strazburg.

...dhe e ardhmja




Pra, duhet të sigurohemi që të gjithëve t'ju dëgjohet zëri për çështjet që vendosen në Bashkimin European.

Si mund ta bëjmë këtë? A keni ndonjë ide të mirë? Cilat mendoni se janë problemet e rëndësishme, me të cilat duhet të merret BE-ja, dhe çfarë do të bënit ju me ato probleme?

Pse të mos i diskutoni dhe t'i shënoni në letër idetë tuaja së bashku me mësuesin tuaj dhe shokët e shoqet e klasës, dhe t'ia dërgoni përfaqësuesit tuaj në Parlamentin European? Për të ditur se kush është ai dhe adresën se ku mund t'i shkruani, mund të hyni në faqen vijuese të internetit: europarl.europa.eu/

Po ashtu, mund të kontaktoni Komisionin European apo Parlamentin në njërën prej adresave në fund të këtij libri.

Tani jemi fëmijët e sotëm të Europës, por shumë shpejt do të bëhemi të rriturit e Europës.



Ne duhet të vendosim për të ardhmen, së bashku!



Adresa të dobishme

Për ju & Për mësuesin tuaj

Pse të mos testoni atë që keni mësuar në këtë libër dhe të luani në internet lojën e quajtur 'Ejani ta zbulojmë Europën'? Mund të hyni në faqen e internetit:

europa.eu/europago/explore

Këndi i fëmijëve



Ju mund të gjeni informacione argëtuese për secilin nga vendet e BE dhe të mësoni më shumë për BE-në tek 'Këndi i fëmijëve'. Është i mbushur me lojëra, gjëza dhe argëtim!

europa.eu/kids-corner



Këndi i mësuesve



Këndi i Bashkimit European në internet për mësuesit është qendër e përgjithshme burimore për materiale

të ndryshme të mësimdhënies lidhur me Bashkimin European dhe me politikat e tij. Ky material është hartuar nga institucione të ndryshme të BE-së, si dhe nga organe të tjera qeveritare e joqeveritare. Pavarësisht nëse kërkon frymëzim për njësitë tuaja mësimore apo kërkon materiale ekzistuese edukative-arsimore për historinë dhe kulturën e Europës, apo edhe nëse kërkon tematika specifike, siç janë ndryshimet klimatike dhe zvogëlimi i konsumit të energjisë, do të mund të gjeni diçka të dobishme dhe të përshtatshme për moshën e nxënësve tuaj në adresën vijuese të internetit:

europa.eu/teachers-corner



Pika kontakti me BE-në



ONLINE

Informacione në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit European mund të gjeni në faqen e internetit Europa: europa.eu



PERSONALISHT

Në mbarë Europën ka qindra qendra lokale informative të BE-së.

Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni në faqen e internetit Europe Direct: europedirect.europa.eu



PËRMES TELEFONIT OSE POSTËS

Europe Direct është shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja mbi Bashkimin European. Këtë shërbim mund ta kontaktoni në telefonin pa pagesë **00 800 6/7/8/9/10/11**, (disa operatorë të telefonave celular nuk lejojnë hyrjen në numrat 00800 ose janë me pagesë), telefonin me pagesë nëse merrni nga vendet jashtë BE-së **+32 2 2999696**, ose me anë të postës elektronike të faqes së internetit Europe Direct: europedirect.europa.eu



LEXONI MBI EUROPËN

Për të lexuar botimet mbi BE-në, duhet të klikoni vetëm një herë në faqen e internetit të librarisë të BE-së: bookshop.europa.eu



NË SHQIPËRI

Ju mund të gjeni informacion dhe broshura mbi Bashkimin European në:

Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri

ABA Business Center, Rr. Papa Gjon Pali II, kati 17

Tiranë, Shqipëri

Faqja e Internetit :

www.eeas.europa.eu/delegations/albania

Telefon: +355 (0)4 222 8320 ose 223 0871 –
222 8479 – 223 4284

Fax: +355 (0)4 223 0752

E-mail: delegation-albania@eeas.europa.eu

ndiq Delegacionin e BE në:

Portal: www.eudalbania.eu

Facebook: www.facebook.com/eu.delegation.albania

Twitter: www.twitter.com/eu_albania

Qendra e Informimit të BE-së në Tiranë

Rr. "Ismail Qemali", Nr. 32

Tiranë, Shqipëri

Faqja e Internetit: www.euinfocentre.al

E-mail: info@euinfocentre.al

Telefon & Fax: +355 (0)4 226 1767

Qendra e Informimit të BE-së në Shkodër

Rr. "Kolë Idromeno" (Pedonale), Nr. 63

Shkodër, Shqipëri

Faqja e Internetit: www.shkodra.euic.al

Telefon & Fax: + 355 (0)22 254 552

Qendra e Informimit të BE-së në Vlorë

Bulevardi "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri

Faqja e Internetit: www.vlora.euic.al

Telefon & Fax: +355 (0)33 408 688

Ministria e Integritimit European

Ministria e Integritimit

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3

Kutia Postare Nr. 8302

Tiranë, Shqipëri

Faqja e Internetit: <http://integrimi.gov.al>

Telefon: +355 (0)4 222 8623, 08000809

Fax: +355 (0)4 222 8623

E-mail: info@integrimi.gov.al

Projekti i Mbështetjes së Proçesit të Integritimit në BE (SMEI 3)

Ministria e Integritimit

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 (0)4 223 6790 / 6741

Faqja e Internetit: <http://smei3.mie.gov.al/en/pages/Home>

E-mail: info@smei3.com

Komisioni European dhe Parlamenti European ka Përfaqësi dhe zyra në të gjitha vendet e Bashkimit European. Bashkimi European gjithashtu ka delegacione në pjesët e tjera të botës.

Të njohim Europën!

Europa: një kontinent i bukur, me një histori magjepsëse. Ajo ka nxjerrë shumë nga shkencëtarët, zbuluesit, artistët, kompozitorët, sportistët, si dhe komikët më të suksesshëm botërorë.

Për shekuj me radhë, Europa ka qenë e pllakosur nga luftërat dhe ndasitë, por në 60 vitet e fundit, vendet e këtij kontinenti të vjetër më në fund janë bashkuar në paqe, miqësi dhe unitet, për të punuar për një Europë dhe një botë më të mirë. Përmes këtij libri për fëmijë (të moshës 9 deri 12 vjeçare) shpjegohen gjërat në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë. Libri është i pasur me fakte interesante dhe ilustrime të larmishme, jep një pasqyrë të qartë të Europës, si dhe shpjegon shkurtimisht se çfarë është Bashkimi Europian dhe si funksionon ai.

Ju sugjerojmë të hyni në faqen e internetit:

<http://europa.eu/europago/explore>

Atje do të gjeni shumë gjëza dhe lojëra për të testuar njohuritë tuaja!

Kënaquni duke zbuluar!



Zyra e Publikimeve

ISBN 978-92-79-32925-8



9 789279 329258